



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 20437/ prot.

Lezhë, më: 30.12.2024

RELACION

**PËR SHPJEGIMIN E PROCEDURËS TË HEQJES NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR
PËR SIPËRFAQET QË DO TË PREKEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT ME
FUNKSION; KOMPLEKS BANIMI DHE SHËRBIMI 5 KATE MBI TOKË DHE 1, 2
KATE NËN TOKË NGA SHOQËRIA "JUNIK" SHPK**

Shoqëria "**JUNIK**" SHPK ka paraqitur kërkesën online me datë 27.11.2024 pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për heqje nga fondi pyjor/kullor të sipërfaqes, ku sipas Vendimit të KKT-së numër 13 datë 09.07.2024 për miratimin e Lejes së Ndërtimit do të ndërtohet objekti; Kompleks banimi dhe shërbimi 5 kate mbi tokë dhe 1, 2 kate nën tokë.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes **0.143 ha** pyll që do të shërbejë për ndërtimin e Kompleksit të banimit dhe shërbimit 5 kate mbi tokë dhe 1, 2 kate nën tokë.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet shkresës numër 7986 protokoll datë 19.12.2024 i është drejtuar Bashkisë Lezhë për hartimin e Raportit Tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakortësisë me vendim të Këshillit Bashkiak për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes që preket nga gjurma e ndërtimit, sipas përcaktimit në pikën 2/d, kapitulli III të VKM-së numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".


Nga ana e Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë është përgatitur raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që preken nga gjurma e ndërtimit. Sipërfaqja pyjore është në pronësi të **Z. Marash Tish Koliçaj** sipas dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria dhe të përcjellura nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe bën pjesë në ngastrën pyjore numër 49a të Ekonomisë Pyjore "Mali i Rrencit".

Në këto kushte, bazuar në ligjin numër 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjin numër 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM-në numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", i propozojmë Këshillit Bashkiak të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **0.143 ha** pyll në pronësi private, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur Projekt-Vendimit.

Hartoi relacionin
Ing. Artan PALUSHI



DREJTORI
Gjek MAKAJ



KRYETARI
Pjerin NDREU

